

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: "Termovision" SH.P.K.; N.N. "Infra - Plus", Q. T. Dard. Te P. e Re Z. Veri N. A Lok. Nr24, 10000, PRISHTINË Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	30.09.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim, të datës: **28.09.2022**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: "Termovision" SH.P.K.; N.N. "Infra - Plus" me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **INSTALIMI I NGROHJES QENDRORE NË BIBLIOTEKËN E QYTETIT DHE SHTËPINË E KULTURËS NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-22-8319-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-035-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: "Termovision" SH.P.K.; N.N. "Infra - Plus" me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **INSTALIMI I NGROHJES QENDRORE NË BIBLIOTEKËN E QYTETIT DHE SHTËPINË E KULTURËS NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-22-8319-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-035-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **23.09.2022**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **INSTALIMI I NGROHJES QENDRORE NË BIBLIOTEKËN E QYTETIT DHE SHTËPINË E KULTURËS NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-22-8319-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-035-5-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik: "Termovision" SH.P.K.; N.N. "Infra - Plus" me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **INSTALIMI I NGROHJES QENDRORE NË BIBLIOTEKËN E QYTETIT DHE SHITËPINË E KULTURËS NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: 623-22-8319-5-2-1, Numër i brendshëm: 623-22-035-5-2-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 23.09.2022, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 28.09.2022, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR:

Pretendimi 2. Autoriteti kontraktues, KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, gjatë vlersimit të ofertave ka bërë shkelje të përgjithshme të LPP-së pasi që nuk e ka ruajtur parimin e trajtimit dhe barazimit jo-diskriminimi. AK me këtë veprim ka bërë diskriminim të OE pasi që nuk ka marrur për bazë kërkeses në FDT ku sipas kërkeses OE duhet të ofroj :

2.4. Dy punëtor të certifikuar si Saldues, të trajnuar dhe certifikuar sipas standardit EN ISO 9606-1 me certifikata valide:

Pas shqimit të dokumentacionit tenderues kemi vërejtur se të dy grupet e operatorve ekonomik si në vijim :

1. Grupi i Operatorve: EKO SYSTEM SH.P.K & H&B Consulting SH.P.K dhe
2. Grupi i Operatorve: HARST GROUP SH.P.K & ECOTERMIKA SH.P.K nuk e plotsojnë kërkesën e lartëcekur sipas rregullave dhe kërkesave ISO standardeve e kryesisht për ISO 9606-1 për saldator.

Grupi i Operatorve: EKO SYSTEM SH.P.K & H&B Consulting SH.P.K ka dorëzuar nga ASQ CERT certifikatën JO VALIDE me AQS T/S 19942019 për z. Enad Gashin dhe certifikatën JO VALIDE me AQS T/S 19952019 për z. Fadil Krasniqi të dyja të lëshuara me datë 27.11.2018 .

Sipas ISO Standardeve për ISO 9606-1 për saldues kërkohej që rritimi të bëhet ç'do tri vite që do të thote që këto certifikata janë jo valide që nga 27.11.2021.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që bazë të Kërkesës tonë për sqarim të Kërkuar kompanisë: AQSCERT, ka konfirmuar se Certifikatat në fjalë, janë të lëshuar nga kompania e lartëcekur.

Andaj pretendimi juaj është i pabazuar.

Gjeni te bashkangjitur e-mail komunikimi:

Pyetje nga A.K: Komuna e Rahovecit:



Thu 9/29/2022 3:54 PM

Prokurimi Rahovec

FW: Kërkesë!

To: info@aqscert.org

Retention Policy: Delivered (5 years)

Export

From: Prokurimi Rahovec
Sent: Thursday, September 29, 2022 8:44 AM
To: info@aqscert.org
Subject: Kërkesë!

I/e nderuar,

Po ju shkruajm nga Komuna e Rahovecit – Republika e Kosovës

Ne si Autoritet Kontraktues jemi në vlerësim të një procedure të prokurimit, prandaj nga një Operator Ekonomik kemi prezantuar Certifikatat e trajnimit për saldator Kërkojmë nga ju si mbajtës së kursit të trajnimit të na informoni rreth validitetit të certifikates me nr:

AQS/T/519952019 në emër të z. FADIL KRASNIQI
AQ5/T/519942019 në emër të z. ERNAD GASHI

Pra kërkojmë që të na informoni se këto certifikata a janë VAUDE

Me respekt:
Zyra e Prokurimit Rahovec

Përgjigje nga Kompania:

From: AQSCert Info
Sent: 29 September 2022 11:17 PM
To: Prokurimi Rahovec <Prokurimi.Rahovec@rks-jpc.org>
Subject: RE: Kërkesë!

Pershendetje te nderuar!

Duke ju lajenduar per kërkesen tuaj ju bejme me dije se Z. Fadil Krasniqi dhe Z. Ernad Gashi kanë kryer Kurs Trajnimi per Saldator ne perioden 21-24/11/2018 dhe certifikatat ne fjale jane VAUDE.

Name of the trained person: FADIL KRASNIQI
Birthdate: 8/5/1978
Number of certificate: AQS/T/519952019
Title of training certificate: Kurs Trajnimi per Saldator
Training date: 21-24/11/2018
Place of training: Kosove
Date of certificate issuance: 27/11/2018
Expiration date:

Name of the trained person: ERNAD GASHI
Birthdate: 18-10-1985
Number of certificate: AQS/T/519942019
Title of training certificate: Kurs Trajnimi per Saldator
Training date: 21-24/11/2018
Place of training: Kosove
Date of certificate issuance: 27/11/2018
Expiration date:

Ju urregje
Gjithe te mirat

Bazuar në të dhënat e lartëcekur Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitive të këtij Vendimi. Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Komuna e Rahovecit